

Rasti kundër Albin Kurtit

Procesi kundër Albin Kurtit, filloi me arrestimin e tij më 10 shkurt 2007, ditën që Vetëvendosja organizoi Demonstratë paqësore në Prishtinë kundër Planit të Ahtisarit dhe për vetëvendosje.

Gjatë kësaj demonstrate, policia rumune e UNMIK-ut, vrau dy protestues, Mon Balajn dhe Arben Xheladinin dhe plagosi 80 të tjerë duke gjuajtur me plumba gome, me afat të skaduar. Më pas vetë UNMIK-u dëshmoi se veprimi policor qe kriminal, i panevojshëm dhe i shmangshëm.

Por, në vend që të ndiqeshin penalisht oficerët përgjegjës u arrestua Albin Kurti, u mbajt në burg për 5 muaj dhe nën arrest shtëpiak për 5 muaj e gjysmë i akuzuar për “udhëheqjen e masës që ka kryer vepra penale”, “thirrje për rezistencë” dhe “pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave të tyre”.

Rasti kundër Albin Kurtit, vazhdimisht ia shkelte të drejtat, veçanërisht të drejtën për gjykim të pa anshëm. Ky gjykim paraqet një diskriminim i bërë ndaj Albin Kurtit duke e konsideruar atë fajtor të ngjarjeve të shkurtit 2007. përderisa nuk ekziston dyshim i bazuar se Albin Kurti është fajtor kryesorë i demonstratave, një proces i tillë gjyqësor nuk ka bazë juridike.

Ligji për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit thotë:

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtëbn e çdo individ i për:

- 1) Barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- 2) Barazi të shanseve dhe mundësive për gëzimin e lirive, ushtrimin e të drejtave sk dhe pjesëmarrje në jetën publike;
- 3) Mbrojtja efikase nga diskriminimi dhe nga çdo formë e nxitjes së diskriminimit.

Neni 3

Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike, ose i personave fizik apo juridik që marrin pjesë në jetën apo sektorët publik, ose privat që krijon baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë disfavorizues, paraqet diskriminim.

Diskriminues, mund ta quajmë edhe rastin kundër Albin Kurtit, ngase kemi një veprim të autoriteteve publike që përdor ndaj tij, një trajtim disfavorizues.

Ishte shumë e qartë që për UNMIK-un, në rastin e Albin Kurtit, prioritet më i madh ishte izolimi i tij, se sa e vërteta dhe drejtësia.

E vërteta ekziston, drejtësia ekziston, duket, por UNMIK-u e bën atë të padukshme, e vërteta është, por UNMIK-u dëshiron që ajo të mos shpaloset, por po e shpalosim ne.

Nuk mund të konsiderohet kryerës i veprës penale, personi që ka mbrojtur të drejtat dhe idealet kombëtare. Kjo është e vërteta.

E drejta e tubimit, liria e shprehjes dhe ajo e lëvizjes janë akorduar sipas Deklaratës Universale të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, ku neni 20 thotë:

1) Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësorë.

Asnjëri nuk duhet të detyrohet të marrë pjesë në ndonjë bashkim dhe në paktin ndërkombëtarë të drejtave civile dhe politike, neni 21:

- 1) Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e rendit të vet drejtpërsëdrejti, ose përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- 2) Gjithkush ka njëlloj të drejte të hyjë në shërbimet publike bë vendin e vet;
- 3) Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetërorë, ku vullneti duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë si dhe votim të fshehtë, ose sipas procedurës për votim të lirë.

Albin Kurti ka organizuar tubim paqësorë për vetëvendosje, qëllimi i të cilit ka qenë realizimi i idealeve kombëtare. Askush nuk ka qenë i detyruar të merr pjesë në demonstratë, por ka qenë vullneti i popullit të Kosovës. Athua vallë konsiderohet vepër penale organizimi i protestave paqësore, athua vallë konsiderohet vepër penale organizimi i protestave për idealet kombëtare? Jo, të gjitha këto paraqesin tipare të heroizmit dhe demokracisë.

Ne e konsiderojmë këtë gjyq të montuar dhe kërkojmë mbylljen e procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit sepse:

- 1) Gjyqi ndaj Albin Kurtit është një cenim i sovranitetit të popullit të Kosovës dhe rikonfirmim i sovranitetit të ndërkombëtarëve të cilët paska të drejtën të vrasin dhe të plagosin banorët e Kosovës dhe të mos dënohen;
- 2) Gjyqi ndaj Albin Kurtit përfaqëson një tendencë të hapur për represionin e lirisë së popullit të Kosovës për t'u shprehur lirisht në mënyrë publike.
- 3) Ky proces paraqet një ndërhyrje shformuese në hartën politike të Evropës.
- 4) Ky proces nuk duhet bërë kundër Albin Kurtit dhe Vetëvendosjes, por duhet të adresojë shqetësimin e familjeve të viktimave dhe duhet të hetojë kriminalitetin e vërtetë, vrasësit e demonstruesve dhe institucionet ndërkombëtare që ende nuk po shfaqin përgjegjësi mbi atë çka ndodhi, duke popullin e Kosovës në një viktimitë të përhershme.
- 5) Ky proces, nuk është proces gjyqësor, por proces arbitrar, që nuk ofron mundësi apelimi, sepse është nisur nga institucionet e EULEX-it dhe UNMIK-ut, që nuk i nënshtrohen drejtësisë së Kosovës, duke përjashtuar popullin e Kosovës nga fusha e drejtësisë.

Ne mendojmë se gjithë kjo që ndodh në Kosovë, nuk është në përputhje me konceptin e Bashkimit Evropian.

Prandaj, apelojmë ndaj të gjitha institucioneve shtetërore në Kosovë që të mos vazhdohet procesi gjyqësor kundër Albin Kurtit, kur gjykimi i tij që ishte në krye të manifestimit tregon se Kosova edhe pas shpalljes së pavarësisë dhe vendosjes së misionit të BE-së, është larg të qenit shoqëri ku drejtësia është në shërbim të qytetarit dhe ku garantohet e Drejta e Fjalës dhe e Drejta e organizimit publik. Demonstruesit shfrytëzuan të drejtën e tyre elementare për të manifestuar vullnetin e popullit në rrugë paqësore.

Nuk ishte Albin Kurti që bëri shkelje të ligjit, nuk ishin demonstruesit që bënë shkelje flagrante të ligjit, por ishin institucionet e Kosovës dhe Institucionet e UNMIK-ut dhe EULEX-it. Kërkojmë që të zbatohet ligji.

Albin Kurtit duhet t'i jepet liria, kurse duhet të dënohen kryerësit e vërtetë.

Fisnike Bekteshi